

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Nata e dytë e "Serenights Festival"/ Korça këndon në ritmet e serenatës
ADRESA	https://www.cna.al/qyteti-im/nata-e-dyte-e-serenights-festival-korca-kendon-ne-ritmet-e-serenates-i474594
BURIMI	cna.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	19 shtator 2026, 05:50:04 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	19 shtator 2026, 05:33:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	741c36b63dd45b8efc8e1bf81deb8570e87db0807b411087f21e8a63bb8340fb
TEKSTI	d9c8a881c24e330c7eca71ebdfc0c7c05e9f0f022bd8bd13d5e3cf5ceb82cf83
PAMJA	00a211cabfd961d7626fef4024bd75a6812dcb3d1555a634bae8e98a2641eb6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	f56339f3d5102b7426e1a975e1a1ab0152038556f91d1f90f76cb81dc4705b56
E MËPARSHMJA	516af0d8b63d008f2af56d9d2dd21fd596356eebb4e0d595af781b9464c551f9
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/f56339f3d5102b7426e1a975e1a1ab0152038556f91d1f90f76cb81dc4705b56

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [AKTUALITET](#)
- [POLITIKË](#)
- [KRONIKA](#)
- [EKONOMI](#)
- [SOCIALE](#)
- [DENONCIM](#)
- [STIL](#)
- [SPORT](#)
- [TECH](#)
- [KULTURE](#)
- [BLOG](#)
- [LIVESTREAM](#)



English
English

E fundit!

x

10:07 Aktualitet

Kryetari i Partisë Republikane, Fatmir Mediu, ka zbuluar p...

Nata e dytë e "Serenights Festival"/ Korça këndon në ritmet e serenatës



19 Shtator 2026, 07:33, Qyteti im CNA



Korça vijon të këndojë në ritmet e serenatës. Nata e dytë e "Serenights Festival" solli në skenë këngëtarë të njohur të qytetit, artistë të rinj dhe një repertor që ndërthur traditën me një interpretim më bashkëkohor. Në qendër të mbrëmjes ishte serenata korçare, si një prej simboleve më të rëndësishme të identitetit kulturor të qytetit.

Prej dekadash, serenata është pjesë e pandarë e jetës kulturore të Korçës. Për këngëtarin dhe krijuesin Mihallaq Andrea, kjo traditë nuk lidhet vetëm me instrumentin apo mënyrën e interpretimit, por me shpirtin e qytetit.

"Po in e dini që unë kam krijuar shumë serenata dhe natyrisht s'më nëlqejnë vetëm ato që kam kënduar, që kam krijuar vetë, po dhe ato që këndon

gjihtë Korça. Qytetet kanë traditë. Kanë dhe histori. Po Korça ka shpirt. Edhe ky shpirt quhet serenatë.”

Andrea thekson se ruajtja e serenatës nuk duhet të kufizohet vetëm të përdorimi i kitarës. Sipas tij, ajo duhet të përcillet te brezat e rinj duke ruajtur emocionin dhe karakterin e këngës korçare, edhe kur interpretohet me formacione të ndryshme muzikore.

“Kur themi për të ruajtur origjinalitetin, ju lutem mos përdorni vetëm termin 'kitarë'. Se po t'ju tregoj për fëmijët e mi, grupet e tyre, shokët, këndojnë me kitarë. Kjo quhet traditë? 'Jo', them unë. Ju do të dëgjoni ata djemtë sot edhe vajzat, janë të mrekullueshëm. Si i këndojnë ato këngë sa bukur në skenë! Edhe me një orkestër gati frymore që s'do të mendonte njeri se kjo orkestër mund t'i dilte një serenatë kaq bukur. Mirëpo serenata ka dhe gazmoren, të cilat na duhen shumë.”



Në të njëjtën linjë është edhe këngëtarë Tomi Kondakçi, i cili e sheh vazhdimësinë e serenatës si një përgjegjësi që kalon nga një brez te tjetri. Ai vlerëson edhe mbështetjen institucionale për ruajtjen dhe promovimin e kësaj tradite.

“Ne tani përcjellim ato që kemi trashëguar nga të parët tanë, nga brezat përpara nesh. Dhe qëllimi është që këtë që ne bëjmë sot, ta bëjnë më të rinjtë nesër. Ashtu siç morëm ne nga këngët e të parëve, këtë të marrin tanët edhe të vazhdojnë me të tyre. Është një vlerë e çmuar që ka Korça.”

Por krahas trashëgimisë, artistët ngrenë edhe shqetësimin për mënyrën se si teknologjia dhe ndryshimi i mënyrës së jetesës kanë ndikuar te zakoni i të rinjve për të kënduar serenata së bashku.

“Kryesisht jo, ka një rënie. Kuptohet teknologjia ka bërë punën e saj që nuk na ndihmon në këtë drejtim. Sa vjen dhe melodia po zbehet. Më vjen keq të shikosh të rinjtë me telefona nëpër duar. Një këngë s'e këndojnë, ose të mblidhen siç mblidhemi ne, brezi ynë, një grup me kitarë të këndojnë. Edhe secili të përfaqësojë veten. Nga kjo tavolinë vijnë edhe këngët.”


Nata e dytë e festivalit solli një ndërthurje mes tingujve tradicionalë të serenatës dhe një fryme më moderne. Drejtuesi artistik i bandës, Rajkard Bardhi, tregon se përballja me repertorin korçar ishte një sfidë artistike, por edhe një mundësi për ta sjellë atë te publiku në një tjetër formë.

“Vijmë te qyteti më romantik i Shqipërisë, me serenatën. Normalisht për ne është një lloj sfide, pasi serenata në Korçë është stampë. Dhe ne jemi munduar që ta risjellim programin që kemi sot me një frymë pak më perëndimore.”

Në skenën e “Serenights” u bashkuan emra të njohur të serenatës korçare, si Mihallaq Andrea, Ermira Kola dhe Tomi Kondakçi, së bashku me artistë të rinj. Një ndërthurje brezash që synon ta mbajë gjallë traditën dhe t'i japë asaj një tjetër dimension përballë publikut të sotëm.

“Normalisht që band-i është fantastik dhe me bashkëpunim me këngëtarët më të njohur të Korçës ndër vite, siç janë Mihallaq Andrea, Ermira Kola, Tomi Kondakçi, gjithashtu kemi dhe të rinjtë cilët promovojnë më së miri serenatën korçare.”





Dhe në thellësi të kësaj muzike mbetet emocion. Dashuria, romantizmi dhe historitë që për dekada janë kënduar nën ballkone, vijojnë të jenë pjesë e identitetit të serenatës.

“Si çdo muzikë tjetër edhe serenata funksionon me ndjesi. Dhe ndjesia e parë që vjen kur përmend serenatën është romanticiteti, tekstet e bukura, ballkonet ku i këndohet dashurisë. Kështu që për sa kohë e ke këtë në mendje, çdo gjë vjen natyrshëm.”

Për artistët e rinj, të ngjiten në skenë përkrah emrave që kanë shkruar historinë e serenatës është një mundësi për të marrë përsipër vazhdimin e kësaj tradite. Erika Ahmeti e përshkruan serenatën si pjesë të pandarë të rritjes dhe identitetit të saj artistik.

“Jam shumë e emocionuar të këndoj pranë Mihallaq Andreas, të këndoj këngët e tij që janë kënduar nga populli korçar gjithmonë dhe jam shumë e lumtur që ne po i përcjellim sërish ato këngë. Gjithashtu me Ermira Kolën kemi për të kënduar bashkë dhe me Tomi Kondakçi. Është një privilegj i madh të këndosh me këta artistë.”

Përtej një mbrëmjeje muzikore, “Serenights Festival” synon të rikthejë në vëmendje një traditë që është përcjellë brez pas brezi dhe që vazhdon të jetë një nga shenjat dalluese të Korçës. Në një kohë kur mënyra e komunikimit dhe e argëtimit ka ndryshuar, këngëtarët kërkojnë që serenata të mos mbetet vetëm pjesë e kujtesës, por të vazhdojë të këndohet edhe nga brezat e rinj.

“Serenata për mua është pothuajse gjithçka. Ne jemi rritur me serenatën, familja ime është rritur me serenatën dhe unë vazhdoj ta trashëgoj traditën.”

Nata e dytë e “Serenights Festival” dëshmoi edhe një herë se serenata mbetet një nga zërat më të veçantë të Korçës. Nga këngëtarët që e kanë shoqëruar ndër vite, tek artistët e rinj që po marrin stafetën, tingujt e saj vijojnë të mbushin qytetin me dashuri, nostalgji dhe emocion. Një traditë që nuk kërkon të mbetet vetëm në të shkuarën, por të vazhdojë të jetojë, të përshtatet dhe të këndohet nga brezi në brez./ **CNA**



CNA

10:20 | 19 shtator

SPORT **MANCINI PUBLIKON LISTËN**
Italia ndryshime të mëdha për Ligën e Kombeve

"LITTLE PARIS" NË KORÇË
09:35 ▼
Policia e Korçës harton planin e masave për garantimin e rendit dhe sigurisë për maratonën ndërkombëtare të së dielës

KURSI I KËMBIMIT
1 XAG = 5340.44 Lek

kuriozitet
Mali Kilimanxharo është maja më e lartë e Afrikës





Të sugjeruara

"SERENIGHTS FESTIVAL", NATA E DYTË E SERENATAVE NË KORÇË

"Serenights Festival"/ Korça nis nesër 4 netët e serenatave

"Korça serenights festival"/ Qyteti nën ritmet e serenatës, ja cilët artistë do të performojnë për 4 net radhazi

Në qytetin e poetëve

"SERENIGHTS FESTIVAL" rikthehet në Korçë/ 4 net, 4 vende dhe një dashuri për serenatën

Kur pëllumbat bëhen jetë/ 28 vite pasion në Pogradec

KoKo Fest mbyll edicionin e 13-të/ "Babai" shpallet shfaqja më e mirë

Nisin regjistrimet në Universitetin e Korçës/ Rritet interesi për ekonominë dhe informatikën

"Dola për një shëtitje"/ Arti bashkon 11 artistë në Korçë

"Korça Serenights", zbulohen risitë e edicionit të tretë/ 4 net serenata, nga rrugicat e qytetit te Pazari i Vjetër

Korani, simbol i liqenit të Pogradecit/ Hidhen 2 milionë rasate, rëndësi edhe për gastronomicën

Festa e Bukës së Re në Drithas/ Tradita 20-vjeçare që bashkon fermerët dhe emigrantët

"Çmenduria" që u bë realitet në detin Jon/ Si u shndërrua toni blu i Gjergj Lucës në thesarin e eksportit shqiptar

Akuzat për "vjedhje" dyersh te biblioteka e re "Thoma Turtulli"/ Projekti sot flet vetë

Festa e Mokrës, edicioni i 7-të/ Mokrarët bashkohen për traditën, këngën dhe gatimet

Damia të Mallit gjatë vitave të luftës/ Ekspozita me fotografi historike e hapur deri të dielën

~~**Pamje të Maliqit gjatë viteve të luftës/ Ekspozita me fotografi historike e hapur në T. Mestri**~~

Festa e Lakrorit në Polenë/ Tradita dhe shija e juglindjes

Ekspozita me fotografi historike/ Arkivi i arkeologut grek sjell pamje të Maliqit gjatë viteve të luftës

Festa e Bishnicës/ Këngë dhe hare në qendrën e fshatit, banorët nuk harrojnë rrënjët

Lyhnida Fusion Fest në Pogradec/ Promovohet turizmi mes natyrës, sportit dhe muzikës

[editorial](#)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.